

Takimi i 63^{te} i Bordit Drejtues të INTOSAI-t qarkore nr. 74

Takimi i 63^{te} i Bordit Drejtues të INTOSAI-t u mbajt në Chengdu, Kinë, më 20 – 21 nëntor 2012.

Në këtë takim ishin të pranishëm 81 përfaqësues nga 31 vende të botës ndër të cilët, SAI-t e Afrikës së Jugut, Kinës, Arabisë Saudite, Austrisë, Bahamas, Bregut të Fildishtë, Ekuadorit, Hungarisë, Indisë, Meksikës, Zelandës së Re, Norvegjisë, Pakistanit, Federatës Ruse, Mbretërisë së Bashkuar, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Venezuelës.

Ishin të pranishëm gjithashtu edhe përfaqësuesit e shtatë grupeve rajonale të INTOSAI-t të cilët raportuan në lidhje me tematika specifike në nivel rajonal; CAROSAI – Bahamas; OLACEFS – Panama; AFROSAI – Kamerun; ASOSAI – Korea; PASAI – Zelanda e Re; ARABOSAI – Arabia Saudite; EUROSAI – Spanja.

Përfaqësues të tjerë të SAI-ve raportuan përpara Bordit Drejtues në lidhje me arritjet e Grupeve të Punës, Komiteteve, Nën Komiteteve, Task Force dhe Projekteve në të cilët janë të përfshirë.

Gjatë këtij takimi u arritën rezultatet e mëposhtme:

- Miratimi i Rregullave Procedurale për INCOSAI-n e XXI që do të mbahet në Pekin, Kinë, më 22 – 27 tetor, 2013.

- U aprovua vendimi mbi Deklaratën e Pekinit që do të adoptohet si dokument final dhe i vetëm në fund të Kongresit. Deklarata e Pekinit do të jetë e përbërë nga pjesët e mëposhtme:

- Pjesa e Parë: Pasqyrë e shkurtër mbi arritjet dhe eksperiencat më të rëndësishme të INTOSAI-t në 60 vitet e fundit;

- Pjesa e Dytë: Përmbledhje e rezultateve të dy temave kryesore të Kongresit, “Auditimi Kombëtar dhe Qeverisja Kombëtare” dhe “Roli i SAI-ve në Ruajtjen e Qëndrueshmërisë Afatgjatë të Politikave Financiare”;

- Pjesa e tretë: Pranimi i rëndësisë së adoptimit dhe zbatimit të planifikimi strategjik për të konfirmuar vizionin dhe vlerat thelbësore të INTOSAI-t.

- Pjesa e Katërt: Pranimi i rëndësisë së shkëmbimit të njohurive dhe rritjes së kapaciteteve duke theksuar nismat e mëdha të INTOSAI-t, si për shembull, Rezolutën e OKB-së për Pavarësinë e SAI-ve dhe miratimin dhe zbatimin e kornizës ISSAI;

- Pjesa e Pestë: Nënvizimi i ISSAI-ve mbi vlerën dhe të mirat e Institucioneve Supreme të Auditimit - të bërë një ndryshim në jetën e qytetarëve.

- Pranimi i plotë i Sudanit të Jugut në Komunitetin e INTOSAI-t si anëtar numër 191.

- Aprovimi i temave kryesore të INTOSAI-t për 2013: “Zbatimi i Rezolutës së Asamblesë të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/66/209 dhe “Zbatimi i ISSAI-ve dhe i INTOSAI GOV”.

- Rivendosja e Task Forcës mbi Planifikim Strategjik nën vëzhgimin e Komitetit e Administrimit dhe Financave.
- Krijimi i Komiteti i Përhershëm dhe Mbikëqyrës i INTOSAI-t mbi Çështjet e Shfaqura Rishtazi nën kryesimin e Presidentit të INTOSAI i cili do të raportojë direkt te Bordi Drejtues.
- Miratimi i dokumentit, mekanizmi i INTOSAI-t për çështjet që shfaqen rishtazi, i cili shpjegon se si INTOSAI do të përballet me çështjet e reja në të ardhmen.
- Vendimi se Kryetari i Komitetit për Ndërtimin e Kapaciteteve në bashkëpunim me IDI-n do të veprojë si pikë kontakti për marrëdhëniet e INTOSAI-t me OECD-DAC dhe me komunitetin e zhvillimit në tërësinë e tij.
- Vendimi që SAI i Emirateve të Bashkuara Arabe do të organizojë INCOSAI-n e XXII-të që do të mbahet në vitin 2016.
- Mbështetje për krijimit të një zgjidhjeje të qëndrueshme për të trajtuar zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kornizës ISSAI në të ardhmen.
- Vendimi për tërheqjen e INTOSAI GOVs 9200, 9210, 9220 dhe 9230.
- Konfirmimi i Përcaktimit të Bordit Drejtues për të lëvizur drejt një zbatimi të plotë në të gjitha aspektet e procesit të rregullt ligjor të Standardeve Profesionale INTOSAI në vitin 2013, duke u bërë thirrje të gjitha Komiteteve, Nën komiteteve, Grupeve të Punës, Task Force dhe Grupeve Projektuese për përputhje me rregulloret e përcaktuara nga procesi i rregullt ligjor.
- Kalimi i Drejtimit të "Nën Komitetit 3: Nxitja e praktikave më të mira dhe sigurimi i cilësisë falë komente të kolegëve" nga SAI i Gjermanisë tek SAI i Sllovakisë, efektiv duke nisur takimit i 63^{të} i Bordit Drejtues, 2012.
- Kalimi i Drejtimit të "Grupit të Punës për Auditimin e Mjedisit" nga SAI i Estonisë tek SAI i Indonezisë, duke nisur nga INCOSAI i XXI, 2013.
- Transformimi i "Task Forcës mbi Krizën Financiare Globale: Sfidat për SAI-t" në "Grupin e Punës për Modernizimin Financiar, për Reformën Rregullatore të Tregjeve dhe Institucioneve Financiare".

1. Politikat e Komunikimit dhe Strategjitë e Komunikimit të INTOSAI-t

Plani Strategjik për periudhën 2011 – 2016 ka identifikuar komunikimin si një nga 6 prioritetet strategjike të INTOSAI-t. Rëndësia e komunikimit, duket edhe nga fakti se Sekretariatet e Përgjithshme të shtatë Grupeve Rajonale të INTOSAI-t kanë mundësi të raportojnë gjatë takimeve të Bordit Drejtues mbi aktivitetet e ndërmarra në lidhje me strategjitë e komunikimit. Faqja zyrtare e INTOSAI-t është përditësuar dhe përmirësuar vazhdimisht dhe rreth 80 përmbledhje ekzekutive, janë hedhur në internet duke filluar nga pranvera e vitit 2012.

Në qershor të vitit 2012, Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t, ka ndërmarrë një studim në lidhje me zbatimin konkret të Udhëzuesit të Komunikimit¹. Sipas këtij studimi është vënë re se

¹ Udhëzuesi i Komunikimit të INTOSAI-t është një dokument zyrtar i adoptuar nga INTOSAI në nëntor të 2010. Dokumenti i plotë gjendet në linkun: <http://www.intosai.org/uploads/intkommrichtlinie.pdf>.

SAI-t kryesisht përdorin mjetet moderne të komunikimit me palët e interesuara. Faqet zyrtare të organizatave të INTOSAI-t si edhe faqja e “*International Journal of Government Auditing*” janë burime të vlefshme informacioni për anëtarët e INTOSAI-t.

2. Task Force i Komitetit të Administrimit dhe Financës (FAC) mbi Parashikimin Financiar të INTOSAI-t

Duke u bazuar në Planin Strategjik 2011 – 2016 propozimet e Task Force për financimet e ardhshme të INTOSAI-t, do të paraqiten gjatë Kongresit të XXI-të të INTOSAI-t. Në këtë kontekst, mbahet parasysh se një organizatë si INTOSAI, në përmbushjen e detyrave të shkëmbimit të njohurive, ideve dhe eksperiencave, duhet të jetë financiarisht e pavarur dhe të financojë aktivitetet e saj nëpërmjet burimeve të brendshme. Financimet e jashtme duhet të përdoren nga INTOSAI vetëm për projekte specifike ku përshkruhen qartësisht përgjegjësitë përkatëse. Kontributet e detyrueshme të SAI-ve, të cilat janë burimi kryesor i financimit për INTOSAI-n, duhet të promovohen vazhdimisht. Gjithashtu, edhe ndihmat dhe financimet nga dhuruesit për zhvillimin e projekteve të INTOSAI-t duhet të jenë një target i vazhdueshëm për të siguruar financime.

3. Grupi i Punës Global i Audituesve të Përgjithshëm

Grupi i punës global (Global Working Group GWG) është rezultat i një iniciative të SAI-t të SH.B.A.-ve, i cili është themeluar në vitin 2000. Është zhvilluar zakonisht si një takim vjetor dhe informal i drejtuesve të SAI-ve. Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t është ftuar të marrë pjesë për herë të parë në takimin e këtij grupi në vitin 2008.

Gjatë takimit të 13^{te} të Grupit të Punës, në maj 2012, u vendos që marrëdhëniet me INTOSAI-n duhet të rakordohen nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtuesve të SAI-ve. Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t duhet të raportojë tek Bordi Drejtues mbi çështjet dhe rezultatet e rëndësishme të Grupit të punës. Drejtuesit e SAI-ve të SH.B.A.-ve, Suedisë, Afrikës së Jugut, dhe Austrisë duhet të këshillojnë Drejtuesit e Grupit GWG.

4. Bashkëpunimet e INTOSAI-t me Organizatat dhe Institucionet Ndërkombëtare

Gjatë takimit, u theksua bashkëpunimi i frytshëm i INTOSAI –t me Kombet e Bashkuara, sidomos me UN DESA edhe në lidhje me Simpoziumin e 22^{te} UN/INTOSAI i cili u mbaj në Vienë, më 5 – 7 mars 2013.

Në një kuadër më të gjerë bashkëpunimi ndër – organizatash, referenca është Platforma e INTOSAI-t për Bashkëpunimin me Kombet e Bashkuara si një iniciativë e rëndësishme për të dy organizatat. Iniciativa e parë e këtij projekti ka qenë mbledhja e publikimeve më temë “Roli i SAI-ve në Luftën kundër Korrupsionit”, një *vademecum* në luftën kundër korrupsionit plotësimi i të cilit është prioritet për të dy organizatat.

Bashkëpunime të tjera midis KB dhe INTOSAI-t janë edhe:

- Statusi i vëzhguesit i DESA-s në Grupin e Punës së INTOSAI-t mbi Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve;
- Konsiderimi i Punës së INTOSAI-t nën shqyrtimin e organizatës së audituesve të jashtëm të Kombeve të Bashkuara dhe agjencitë e tyre të specializuara (Paneli i Audituesve të Jashtëm të Kombeve të Bashkuara);
- Bashkëpunimi midis INTOSAI-t dhe UNITAR-it (*United Nations Training and Research Institute*) dhe UNCTAD (*United Nations Conference on Trade and Development*);
- Bashkëpunimi midis Grupit të Punës së INTOSAI-t mbi Auditimin Mjedisor dhe UNEP (*United Nations Environmental Program*);
- Bashkëpunimi midis Grupit të Punës së INTOSAI-t mbi Përgjegjësitë dhe Auditimin e Ndhimave në raste Katastrofash dhe INISDR (*United Nations International Strategy for Disaster Reduction Secretariat*);

5. Zbatimi i Planit Strategjik 2011 – 2016

Zbatimi i Planit Strategjik 2011 – 2016, po ecën në mënyrë të shkëlqyer dhe për këtë arsye falënderimet nuk munguan në drejtim të anëtarëve për punën e bërë. Lidhur me sa më lart, informacioni i paraqitur nga drejtuesja e Planifikimit Strategjik, tregoi se deri tani, masat e nevojshme për zbatimin e planit, janë ndërmarrë në masë 60%. Gjithashtu, u informua edhe mbi nevojën për formulimin e opinioneve dhe dokumenteve për hartimin e Planit Strategjik të INTOSAI-t 2017 – 2022. Për këtë arsye, u theksua se është e rëndësishme të promovohet një bashkëpunim dhe shkëmbim opinionesh midis Komiteteve të qëllimeve strategjike, Grupeve të punës rajonale dhe organet e tjera të brendshme të INTOSAI-t.

6. Bashkëpunimi me Grupet e Punës Rajonale

Rritja e bashkëpunimit ndërmjet INTOSAI-t dhe Grupeve Rajonale, ka qenë plotësisht në linjë me Planin Strategjik. Më tej, u prezantua edhe një listë e Kongreseve dhe Asambleve të Përgjithshme që janë mbajtur gjatë 2012:

- XII ASOSAI – Asamble e Përgjithshme, mbajtur në Jaipur, Indi, 29 shkurt – 03 mars 2012;
- VII EUROSAI/OLACEFS – Konferencë, mbajtur në Tbilisi, Gjeorgji, 17 – 19 shtator 2013;
- XV PASAI – Kongres, mbajtur në Noumea, Kaledonia e Re, 2 – 5 tetor 2013;
- XXII OLACEFS – Asamble e Përgjithshme, mbajtur në Gramado, Brazil, 5 – 10 nëntor 2013.